

**VENDIM**

Nr. 5, Datë 02/02/2016

**PËR**

**MIRATIM E NUMRIT TË SENATIT AKADEMIK DHE BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË  
UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Në zbatim të, neni 37- Senati Akademik, neni 38 - Funksonet e Senatit Akademik, neni 47- Bordi i Administrimit, Neni 48 - Përbërja dhe krijimi i Bordit të Administrimit, të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", shkresës nr.688 prot., date 26.01.2016, të MAS, Relacionit të Kryetarit të Senatit Akademik, Prof. Petrit MALAJ,

**VENDOSI**

1. Senati është organi kolegjal vendimmarrës më i lartë akademik i Universitetit të Arteve, që përcakton politikat e zhvillimit të UART, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.

2. Senati kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht.

3. Anëtarët e Senatit Akademik të Universitetit të Arteve zgjidhen nga asambletë e personelit akademik të njësive kryesore, (fakulteteve) përmes një votimi të përgjithshëm, për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.

4. Anëtarët e senatit në institucionet e arsimit të lartë i përkasin kategorisë "**Profesor**" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së.

5. Në Senatin Akademik UART përfaqësohen edhe studentët, në masën rreth dhjetë për qind.

6. Numri i anëtarëve, të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve është **19** (nëntëmbëdhjetë) **persona**.

7. **Përbërja** e Senatit Akademik të Universitetit të Arteve është si më poshtë:

- a. Rektori i Universitetit të Arteve;
- b. Dekanët e zgjedhur të Fakulteteve të Universitetit të Arteve;
- c. Katër përfaqësues të Fakultetit të Muzikës;
- ç. Katër përfaqësues të Fakultetit të Artit Skenik;
- d. Katër përfaqësues të Fakultetit të Arteve të Bukura;
- e. Tre përfaqësues të studentëve.



8. Krijimin e Bordi të Administrimit të Universitetit të Arteve, si organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të Universitetit të Arteve, mbarëvajtjen financiare, administrative dhe të pronave të tij;

9. Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Tre Anëtarët përfaqësues të UAR-it, përzgjidhen nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve për një mandat pesëvjeçar, nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë, me të drejtë rizgjedhjeje. Çdo fakultet ka një përfaqësues në Bordin e Administrimit;

10. Këto ndryshime të pasqyrohen në Statutin e Universitetit të Arteve.

**Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Gazmend LEKA

Prof. Milto KUTALI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Astrit SELITA

Miranda BAKIASI

ELIA PLAKU ADEMI

Enisa VRENOZAJ

Albjan VUKA

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr.Zana Shuteriqi/Prela

Prof. Asoc. Haig ZACHARIAN

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Fatmir MIZIRI

Ramazan GURRA

Kristina AGO